



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 628/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me apelin e Hilmi Hoxha, anëtarë për Kuvendin Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Hilmi Hoxha, anëtarë për Kuvendin Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjë ZL.Anr.628/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.628/2017 me datën 09.11.2017, nga Hilmi Hoxha, anëtarë për Kuvendin Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik PDK, në të cilën thekson se e kanë votuar familjarët në këto Qendra të votimit: 1808e/01R dhe 1831e/02D, por që i mungojnë votat.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar**

Paneli pretendimet ankimore të parashtruesit të apelit i vlerësoj si te pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj për arsye se gjatë hetimit të bërë nga ekipi hetues i PZAP-it me datë 11.11.2017 në kutitë e votimit: 1808e/01R dhe 1831e/02D në QNR, konstatoi se në vendvotimet 1808e/01R dhe 1831e/02D në QNR nuk ka pasur ndryshim të votave nga numri i votave të shpallura me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nr. 2232-2017 të datës 08.11.2017.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase pretendimet e parashtruesit të apelit sipas hetimit të bërë nga PZAP, nuk qëndrojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.628/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuese e Panelit**  
Gyltenc Sylejmani



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*